



REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVORE REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr. Prot.	03-02/4911/1
Dep.		Br. Prot.	
Nr. I faq.	02	Prot No.	
Broj stranica		Data	30.12.2016
Nr. pages		Datum	30.12.2016
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3374/16, për z. Dukaxhin Zogaj, Drejtor në Klinikën e Alergologjisë të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Dukaxhin Zogaj, Drejtor në Klinikën e Alergologjisë të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në bizneset privat Sh.P.K “Z-Lab”, N.T.Sh “Alergjia - Astma” dhe N.P.T “Rr & Rr”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Zogaj është njoftuar se zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka rekomanduar zyrtarit të lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në bizneset private, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do ti bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresat zyrtare (DPKI.03-02/4902/16) (DPKI.03-02/4903/16)(DPKI.03-02/4904/16), me të cilat dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të lartë cekura. Me këtë rast zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

